



A.nr.922/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2793/2022 të datës 29.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, te vërtetuar sipas Aktgjykimit A.nr.653/2024 të datës 20.01.2026 të Gjykatës se Apelit Departamenti për Çështje Administrative, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.922/2022, të datës 31.08.2022, të parashtruar nga ankuesi I.K, nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.17/22, te datës 02.09.2022 të Zëvendësueses së Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, në çështjen juridike “*Ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.753/2022 e datës 31.08.2022, e parashtruar nga ankuesi I.K.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Akti. Nr.17/2022 i datës 03.08.2022 i Zëvendësueses së Udhëheqëses të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë si dhe Akt i Emërimit AE.nr.01/2022 i datës 03.08.2022.

III. Shfuqizohet Vendimi me numër A.nr.902/2021 i datës 17.12.2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi I.K, me datë datën 31.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.753/2022, kundër Vendimit me shifër Nr.17/2022 i datës 03.08.2022 i Zëvendësueses së Udhëheqëses të Burimeve Njerëzore në

Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, akt të cilin sipas shkresave të lëndës është konstatuar se i njëjti e ka pranuar me datë 14.09.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në MPJD. Këshilli, me datë 01.11.2022 me numër protokolli:6605/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në procedurë administrative ka administruar këto prova: Vendimin e Këshillit A.nr.753/2022 të datës 28.10.2022; Aktvendimin e datës 04.10.2023 të GJTHP-DÇA me padinë e palës paditëse; Aktgjykimin A.Nr.2793/2022 të datës 29.05.2024 të GJTHP-DÇA; Ankesën e Këshillit e datës 12.07.2024 parashtruar në GJ.A.K; Aktgjykimin AA.nr.653/2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Ankesën e datës 17.10.2022, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 28.09.2022; Vendimin e datës 31.08.2022 e Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme; Shkresa e librit të protokollit e datës 14.09.2022; E-mailin ne datës 28.01.2012 dërguar nga Zyra e Personalit për ankuesin; E-mailin e datës 02.06.2012 dërguar nga Zyra e Personalit për ankuesin; Vendimin për emërimin e ankuesit dhe caktimin e gradës diplomatike i datës 05.07.2013 i nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 30.12.2015 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 14.03.2016 të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin Nr.39/2018 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 13.07.2018 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 27.03.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; E-mailin e datës 03.05.2020 dërguar nga ankuesi për A.P; Vendimin e datës 14.05.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 30.06.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin e datës 10.07.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme; Vendimin për sistemimin të përhershëm i datës 01.09.2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD; Akt emërimin e ankuesit të datës 19.02.2021 me numër AE.nr.03/2021; Vendimin e datës 12.11.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 07.03.2022 për lejimin e pushimit pa pagesë lëshuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; E-mailin e datës 29.07.2022 dërguar nga ankuesi për A.B; E-mailin e datës 06.09.2022 dërguar nga ankuesi për A.B; E-mailin e datës 08.09.2022 e dërguar nga ankuesi për A.B; Zarfën postar i datës 13.10.2022 me numër R2482154; Përgjigjen në ankesë e datës 01.11.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së për Këshillin; Kërkesën për punësim të ankuesit i datës 22.08.2011; Listën e kandidatëve aplikues për misione konsullore i periudhës Gusht 2011; Listën e kandidatëve aplikues për misione diplomatike i periudhës Gusht 2011; Vendimin e datës 21.07.2011 për shpalljen e konkursit; Vendimin e Këshillit A.nr.924/2022 i datës 30.11.2022; Aktgjykimin A.nr.2868/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 29.05.2024; Ankesën e datës 09.07.2024 të parashtruar në Gjykatën e Apelit të Kosovës; Aktgjykimin AA.nr.652/2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 20.01.2026; Vendimin e Këshillit A.nr.924/2022 i datës 30.11.2022; Aktgjykimin A.nr.1346/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 05.04.2023; Aktgjykimin AA.nr.398/2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës të datës 11.07.2024; Aktgjykimin ARJ.nr.138/2024 të Gjykatës Supreme në Prishtinë të datës 21.01.2025; Aktvendimin Nr.ref:RK 2730/2025 i Gjykatës Kushtuese i datës 21.07.2025.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit I.K, **është e pabazuar sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit kishte konstatuar se përmes Vendimit të datës 29.01.2018 pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit, ankuesi ishte emëruar Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me mandat tre (3) vjeçar, mirëpo kundër kësaj procedure të rekrutimit kishte parashtruar ankesë në Këshill ankuesja GJ.H. me datë 03.05.2018, ndërsa Këshilli me datë 19.06.2018 kishte nxjerrë vendimin A.nr.257/2018 përmes të cilit e kishte aprovuar ankesën e ankueses GJ.H, ndërsa e kishte shfuqizuar Vendimin e datës 04.04.2018 me numër:1107 të Komisionit për Ankesave për Pozita të Larta Drejtuese i Ministrisë së Administratës Publikë, dhe e kishte anuluar konkursin për pozitën *“Udhëheqës Ekzekutiv i Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore”* në të cilën ishte zgjedhur ankuesi.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në cilësi të palës në procedurë, kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kundër Vendimit të Këshillit me shifër A.nr.257/2018 të datës 19.06.2022, ndërsa Gjykatat Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 24.03.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.1827/18 përmes të cilit e kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditësit-Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, kurse e kishte anuluar vendimin e Këshillit të datës 19.06.2018 më shifër A.nr.257/2018 dhe lëndën e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i paditur.

Mirëpo, pala e interesit, ankuesja GJ.H të cilës i ishte aprovuar ankesa sipas Vendimit me A.nr.257/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të datës 19.06.2018, kundër Aktgjykimit A.nr.1827/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka parashtruar padi në Gjykatën e Apelit të Kosovës me datë 27.04.2018. Gjykatat e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me datë 07.06.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.574/2021 përmes të cilit e ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës së interesit GJ.H, duke e ndryshuar Aktgjykimin A.nr.1827/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa e refuzon si të pa bazuar kërkesë padinë e palës paditëse Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për lënien në fuqi të vendimit të datës 29.01.2018 dhe anulimin e Vendimit të Këshillit A.nr.257/2018 i datës 19.06.2018.

Zëvendësuesja e Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.574/2021 të datës 07.06.2022, me datë 03.08.2022 ka marr Vendimi me numër Akti.Nr.17/2022 përmes të cilit e ka anuluar Vendimin me Nr.14/2021 të datës 09.09.2021 për emërimin e ankuesit në pozitën e kategorisë se mesme drejtuese.

Ankuesi me datë 31.08.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër aktit të kontestuar me pretendimet ankimore për shkelje materiale dhe procedurale, dhe se i njëjti akt nuk përmbush parakushtet ligjore të përcaktuara nga nenin 48 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, objekti për të cilin ishte nxjerr akti i kontestuar është bërë i pamundur mbi bazën e nenit 51 paragrafi 4 të të njëjtit ligj, me kërkesën që të aprovohet ankesa e ankuesit ndërsa

akti i kontestuar të anulohet si dhe të detyrohet organi i punësimit të zbatojë Vendimin e Këshillit A.nr.902/2021 të datës 17.12.2021.

Këshilli në procedurë administrative me datë 28.10.2022 kishte nxjerrë Vendimin A.nr.753/2022 përmes të cilit e kishte refuzuar ankesën e ankuesit të datës 31.08.2022 ndërsa e kishte lënë në fuqi Vendimin me shifër Nr.17/2022 i datës 03.08.2022 të Zëvendësueses së Udhëheqëses të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë si dhe Akt i Emërimit AE.nr.01/2022 i datës 03.08.2022 i cili palës i ishte lëshuar mbi bazën e aktit të kontestuar.

Pala ankuese, kundër vendimit të Këshillit A.nr.753/2022 të datës 28.10.2022 kishte hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kurse kjo e fundit përmes Aktgjykimit A.nr.2793/2022 të datës 29.05.2024 e kishte aprovuar kërkesëpadinë e palës paditëse, e kishte anuluar Vendimin e Këshillit A.nr.753/2022 dhe çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, me arsyetimin se Këshilli/KPMSHCK si organ i paditur, Vendimin A.nr.753/2022 të datës 28.10.2022 në procedurë të konfliktit administrativ nuk kishte arritur ta mbështesë me prova apo argumente vendimmarrjen duke mos kthyer as përgjigje në padi, dhe si rrjedhojë është aprovuar padia e palës paditëse ngase e paditura nuk kishte mundur ta argumentoj me prova materiale të kundërtën.

Këshilli, kundër Aktgjykimit A.nr.2793/2022 të datës 29.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke dhënë argumentet e nevojshme ligjore dhe të njëjtët duke i mbështetur me prova material se konstatimi Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti në Prishtinë lidhur me mos dërgimin e provave material ishte i saktë, mirëpo në kohën e pranimit të Aktvendimit në fjalë lidhur me lëndën A.nr.2793/2022, Këshilli ishte në fazën e ndërrimit të lokacionit/zyrave prej të cilave vepron, sikurse ishte në zhvendosje e gjithë baza e lëndëve arkivore për të gjitha çështjet aktive dhe ato në procedurë sikurse edhe e gjithë aparatura që përdoret nga zyrtarët për ushtrimin e funksioneve në baza ditore ishte në zhvendosje e sipër, madje në Gjykatën e Apelit të Kosovës janë dërguar provat si në vijim: Njoftimi përmes e-mailit të datës 09.11.2023 dërguar Administratorit të Gjykatës dhe Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe njoftimi i datës 09.11.2023 përmes e-maili i Administratorit të Gjykatës, dërguar Gjyqtarëve të Departamentit për Çështje Administrative, përmes të cilave shkresa Gjykata e Shkallës së Parë/Gjykata Themelore në Prishtinë ishte njoftuar për rrethanat objektive, sikurse e njëjta nuk kishte dërguar një aktvendim të dytë në afat të mëvonshëm, mirëpo Gjykata e Apelit të Kosovës, përmes Aktgjykimit AA.nr.653/2024 të datës 20.01.2026 (pranuar në Këshill me datë 05.02.2026) e ka refuzuar ankesën e këshillit, ndërsa Aktgjykimin A.nr.2793/2022 të datës 29.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative e ka vërtetuar.

Duke marrë parasysh detyrimet ligjore që rrjedhin sipas aktgjykimeve respektive, Këshilli e ka aktivizuar lëndën e ankuesit, me qëllim të rishqyrtimit, mirëpo duke marrë parasysh faktin që padia e palës paditëse ishte aprovuar sipas Aktgjykimit A.nr.2793/2022 të datës 29.05.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, për arsyet e dhëna si më lartë, ashtu që gjykata në fjalë nuk kishte konstatuar në parim se Këshilli me rastin e vendimmarrjes sipas

A.nr.753/2022 të datës 28.10.2022 te ketë shkelur ligjin material apo të ketë zbatuar gabimisht të drejtën materiale, Kolegji i Këshillit thekson faktin se nuk ka sesi të vendos ndryshe përveç asaj që është konstatuar në vendimin paraprak i cili është anuluar për shkaqe procedurale, ngase akti i kontestuar në Këshill, respektivisht Vendimi Nr.17/2022 i datës 03.08.2022 i Zëvendësueses së Udhëheqëses të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore si dhe Akt i Emërimit AE.nr.01/2022 i datës 03.08.2022 si derivat i tij, janë nxjerrë mbi qëllim të zbatimit të detyrimeve ligjore që kanë rrjedhë nga Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.574/2021 të datës 07.06.2022, përmes të cilit ishte vendosur në meritë duke bërë konstatimit edhe të zbatimit të ligjit material në veçanti.

Prandaj, Kolegji i Këshillit thekson faktin se pretendimet ankimore të ankuesit cili pretendon që të realizojë të drejta të cilat kanë rrjedh apo janë derivat i Vendimit të datës 19.01.2018 përmes të cilit ankuesi ishte emëruar Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, ngase Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit A.nr.574/2021 me datë 07.06.2022, përmes të cilit e ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës së interesit GJ.H, duke e ndryshuar Aktgjykimin A.nr.1827/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, dhe duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesë padinë e palës paditëse-Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për lënien në fuqi të vendimit të datës 29.01.2018, rrjedhimisht Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të saj ka vërtetuar ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit A.nr.257/2018 të datës 19.06.2018 përmes të cilit ishte konstatuar fakti se procedura e rekrutimit për Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore në të cilën procedurë ishte përzgjedhur ankuesi I.K, ishte zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit material, respektivisht në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, andaj Vendimi Nr.17/2022 i datës 03.08.2022 i Zëvendësueses së Udhëheqëses se Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore është i drejtë dhe i ligjshëm rrjedhimisht nxjerrja e tij është bazuar në Aktgjykimit A.nr.574/2021 e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative të datës 07.06.2022.

Thënë si më lartë, pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit konstaton se janë të paqëndrueshme, ngase Vendimi me Nr.14/2021 i datës 09.09.2021 i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore sikurse edhe Vendimi A.nr.902/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 17.12.2021 janë nxjerrë në frymën e dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publikë nenit 83 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton që: *“Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës”* si dhe nenit 42 paragrafit 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: *“Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale”*, ngase pavarësisht që sipas Vendimit të Këshillit të datës 19.06.2018 me numër A.nr.257/2018 pozita e Udhëheqësit Ekzekutiv në të cilën ishte përzgjedhur ankuesi I.K ishte

anuluar, i njëjti kishte vazhduar ta ushtrojë detyrën e tij deri në vendosjen nga Gjykatat e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit AA.nr.574/2021 të datës 07.06.2022.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative ku parashihet se: *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj”*, që vendimin e Këshillit të pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.12.2021 me numër A.nr.902/2021 ta shfuqizojë si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit A.nr.574/2021 me datë 07.06.2022 nga Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, rrethanat juridike mbi bazën e të cilave është nxjerrë Vendimi Këshillit A.nr.902/2021 kanë ndryshuar.

Ndërlidhur me këtë, me qëllim të ruajtjes dhe vlerësimit të parimit të përgjithshëm të sigurisë juridike, Këshilli me datë 26.10.2022 i ishte drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, me pyetjen sqaruese, **citoj**: *“Me qëllim të shqyrtimit dhe vendosjes meritore ndërlidhur me ankesën A.nr.753/2022 të ankuesit I.K, kërkojmë nga ana juaj, sqarim si vijon: 1. Sipas përgjigjes suaj në ankesë të datës 16.09.2022, ankuesi përpara se të emërohet ne pozitën e Udhëheqësit Ekzekutiv me datë 29.01.2018, ka mbajtur pozitën: “Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale”; 2. Andaj kërkesa jonë me qëllim sqarimi të rrethanave është: Pas nxjerrjes së Vendimit të datës 03.08.202 me shifër Akti.nr.17/2022, përmes të cilit është anuluar vendimi me Nr.14/2021 i datës 09.09.2021, kërkojmë të dimë se çfarë pozite ushtron ankuesi aktualisht (me vendim apo akt emërim) dhe a ka ndonjë pozitë aktuale të lirë që është ekuivalente me pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pozitë të cilën ankuesi e ka mbajtur përpara se të zgjidhet Udhëheqës Ekzekutiv”, dhe me datë 26.10.2022 Këshilli (KPMSHCK) ka pranuar përgjigjen si vijon, citoj: “Pas nxjerrjes së Vendimit të datës 03.08.2022 Akti.nr.17/2022 , z.I.K është sistemuar në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale. Pozitë të cilën z. Koci ka mbajtur përpara se të emërohet në pozitën e Udhëheqësit Ekzekutiv. Për dëshmi , dërgojmë: Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, 2015; Akt emërimi për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale 01/2022”, nga rrjedh se ankuesi I.K me Akt Emërim tani më është konfirmuar në detyrë, respektivisht është emëruar në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pozitë të cilën e ka ushtruar edhe përpara datës 29.01.2018 kur ishte zgjedhur Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor*

Andaj, bazuar në rrethanat e cekura si me lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.922/2024

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJARAKTARI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.K;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative;
- Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.